



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2021

Njoftimi i kontratës për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të autoritetit kontraktor

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Ministria e Mbrojtjes
Adresa Rruga e Dibrës, (ish Shkolla e Bashkuar), Tiranë
Tel/Fax (04) 2226601/ (04) 2226602
Kutia Postare 2423
E-mail prokurimeushtarake@mod.gov.al
Adresa e Internetit www.mod.gov.al

- 2. Lloji i procedurës së prokurimit:** “Procedurë e kufizuar” – prokurim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.
- 3. Objekti i kontratës:** “Ndërtimi i sistemit të transmetimit shumëkanalësh me valë (radio rele digitale)” (Kontratë - Mallra)
- 4. Numri i referencës së procedurës:** Urdhri i prokurimit nr. 29, datë 06.7.2021.
- 5. Fondi limit:** 16,117,600 (gjashtëmbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.
- 6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**
Kohëzgjatja në **ditë 30**
ose
duke filluar nga lidhja e kontratës me përfundim brenda 30 ditëve.
- 7. Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje (faza e parë):**
31/10/2021 (dd/mm/vvvv) Ora:10:00

Kjo procedurë prokurimi do të zhvillohet në bazë të ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” dhe përfshin dy faza kryesore:

Faza 1 – Parakualifikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve:

Faza e parë (para kualifikimi) ka të bëjë me përzgjedhjen e kandidatëve, përpara dërgimit të ftesës për ofertë nga AK-ja. Para kualifikimi i ofertuesve është një proces i ndryshëm nga procedura e vlerësimit të ofertave, e cila përqendrohet në çmimin dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Procesi i para kualifikimit do të bëhet duke u përqendruar në vlerësimin e përvojës dhe aftësinë e kandidatëve për të zbatuar në mënyrë të kënaqshme kontratën konkrete. Qëllimi kryesor i para kualifikimit është përzgjedhja e atyre kontraktorëve /furnitorëve, kualifikimet dhe përvoja e të cilëve minimizon rrezikun e mosekzekutimit, sipas projektit/kontratës së propozuar.

Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në Fazën e Parë, janë përkatësisht si më poshtë:

Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

- Kandidatët e interesuar duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin Certifikatën e Sigurimit Industrial (CSI), e cila duhet të jetë:
 - Jo më e ulët se niveli i klasifikimit “Konfidencial”;
 - E vlefshme në momentin e prokurimit dhe të lidhjes së kontratës së klasifikuar;
 - Në përputhje me objektin specifik të prokurimit të klasifikuar.

Kapaciteti teknik:

- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se kanë përvojë të suksesshme në kontrata të klasifikuara për funizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët ekonomike duhet te paraqesin :

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik operatori ekonomik si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet te paraqes vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Faza 2 - Ftesa për Ofertë dhe vlerësimi: Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët të cilët kanë plotësuar kërkesat për para-kualifikim duke i ftuar të dorëzojnë ofertat sipas përcaktimeve në DT dhe të specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën, fituese.